

Në bazë të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-95570/19 dt. 25.04.2019, të investitorit “Art Construction” L.L.C. nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për “objektin 4”-ndërtesa shumë banesore me afarizëm, Lamela “A” me etazhitet 2B+P+7 dhe Lamela “B” me etazhitet B+S+P+7, në rrugën “Xhafer Shala”, Blloku urban C-9, Lagjja “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 06.06.2019 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarëve Njazi Biqkaj, Sherif Berisha, Ilir Murati dhe Refik Ismajli nga Prishtina, me investitorin “**Art Construction L.L.C.**” nga Prishtina me përfaqësues Faton Sinani, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-95570/19 dt. 25.04.2019, për përdorimin e ndërtesës shumë banesore me afarizëm, ”objekti 4” Lamela “A” me etazhitet 2B+P+7 dhe Lamela “B” me etazhitet B+S+P+7, e ndërtuar në kuadër të parcelës kadastrale nr. P-71914050-01576-0, Zona Kadastrale Matičan sipas Vendimit 05 nr.351-259707 dt. 28.12.2016 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës si dhe Vendimit me numër 05 nr.351-259707 dt. 12.12.2017 mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të lejes së ndërtimit.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-259707 dt. 28.12.2016, Vendimit me numër 05 nr.351-259707 dt. 12.12.2017 mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të lejes së ndërtimit, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pronarët Njazi Biqkaj, Sherif Berisha, Ilir Murati dhe Refik Ismajli nga Prishtina, me investitorin “**Art Construction L.L.C.**” nga Prishtina me përfaqësues Faton Sinani, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-95570/19 dt. 25.04.2019, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës administrative, ”objekti 4” Lamela “A” me etazhitet 2B+P+7 dhe Lamela “B” me etazhitet B+S+P+7, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Vendimin nr. 05 Nr. 351-259707 dt. 28.12.2016 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, ”objekti 4” Lamela “A” me etazhitet 2B+P+7 dhe Lamela “B” me etazhitet B+S+P+7 të pronarëve Njazi Biqkaj, Sherif Berisha, Ilir Murati dhe Refik Ismajli nga

Prishtina me investitor “Art Construction L.L.C.” nga Prishtina me përfaqësues Faton Sinani në kuadër të bllokut urban C-9 , në kuadër të parcelës kadastrale nr. 01576-0 e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914050-01576-0 ZK. Matiçan.

- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Aktvendimin numër 05 Nr. 351-259707 dt.02.12.2016, mbi caktimin e taksës Administrative për lejimin ë ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Konkluzionin për përmirësimin e gabimit teknik 05 Nr. 351-259707 dt. 21.12.2017 të Aktvendimin numër 05 Nr. 351-259707 dt.02.12.2016, mbi caktimin e taksës Administrative për lejimin ë ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Konstatim mbi caktimin e pikave të objektit me nr. të referencës 05-945/01-20175/17 të dt.08.02.2017.
- Vendimin me numër 05 nr.351-259707 dt. 12.12.2017 mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të lejes së ndërtimit.
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/02-78631/19 dt. 04.04.2019, Rr. “Xhafer Shala”
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes,
 - Sevdar Bektoshi, IDA. udhëheqës i vend ndërtimit,
 - Naim Matoshi, IDA. mbikëqyrës për arkitekturë,
 - Sami Idrizi IND. mbikëqyrës për Strukturë,
 - Ismet Haliti, IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime,
 - Kushtrim Krasniqi, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike,
 - Gazmend Krasniqi, IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike,
 - Naser Berisha, IDA. mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri,
 - Valon Bislimi, gjeodet.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Dëshmi se të gjitha pagesat janë bërë,
- Protokollet e miratuara për te gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Njëkohësisht nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit përmes shkresës nr. 09 Nr.391/02-47345/19 dt. 15.04.2018 ka arritur ne Drejtori: Formulari i Inspektimit Final sipas UA. 05/2017 i plotësuar nga Drejtoria përkatëse, Raporti Final i inspektorëve, njoftim për punët e kryera në objekt si dhe foto të objektit të realizuar.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektimit Final të Inspektionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-95570/19 dt. 25.04.2019, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen Ndërtimore 05

Nr.351-259707 dt. 28.12.2016. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm, mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

Kërkesat e Vendimit 05 Nr. 351-259707 të datës 28.12.2016-Lejes së Ndërtimit janë zbatuar, dhe Vendimit me numër 05 nr.351-259707 dt. 12.12.2017 mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të lejes së ndërtimit.

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë ndërmarrë.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm, "objekti 4" Lamela "A" me etazhitet 2B+P+7 dhe Lamela "B" me etazhitet B+S+P+7, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.


Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë të përdorimit, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-95570/19 DT. 06.06.2019**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Mimoza Berisha Prestreshi

